



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

Ac.nr.1832/2018

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Hunaida Pasuli kryetare e kolegjit, Gani Avdiu dhe Faton Ademi, anëtarë, në çështjen juridike kontestimore të paditësve U.H. dhe A.A. që të dy nga Fushë Kosova, të cilët i përfaqëson J.I. avokat nga Prishtina, kundër të paditurave Kompania e Sigurimeve “S...” në Prishtinë, të cilën e përfaqëson K.P. dhe Byroja Kosovare e Sigurimeve në Prishtinë, të cilën e përfaqëson Laura Hoti, për kompensimin e dëmit material dhe jomaterial, duke vendosur sipas ankesave të autorizuara të të paditurave, të paraqitura kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, C.nr.2307/2012 të datës 15.12.2017, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 15.07.2021, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHEN si të pabazuara ankesa e të paditurës Kompania e Sigurimeve “S...” në Prishtinë dhe ankesa e të paditurës Byroja Kosovare e Sigurimeve në Prishtinë, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil C.nr.2307/2012 i datës 15.12.2017, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë, me aktgjykimin e ankimuar C.nr.2307/2012 të datës 15.12.2017, në pikën I (një) të dispozitivit e ka aprovuar pjesërisht si të bazuar kërkesëpadinë të paditësve U.H. dhe A.A. që të dy nga Fushë Kosova dhe ka detyruar të paditurën Kompania e Sigurimeve “S...” në Prishtinë, që paditësit U.H. nga Fushë Kosova në emër të kompensimit të dëmit jomaterial dhe material të shkaktuar si pasojë e lëndimeve të pësuar në aksidentin e komunikacionit të datës 24.10.2008 nga baza e autopërgjegjësisë në bazë të përgjegjësisë së ndarë dhe atë 70 % t’ia paguaj paditësit, shumat si në vijim:

Në emër të dëmit jo material:

për dhimbje fizike shumë prej 3,000.00 Euro,

për shkak të frikës së përjetuar shumë prej 1,500.00 Euro,

për shkak të zvogëlimit të aktivitetit jetësor shumë prej 1,500.00 Euro.

Në emër të dëmit material:

në emër të përkujdesjes së personit tjetër shumën prej 70.00 Euro,

në emër të ushqimit të përforcuar shumën prej 70.00 Euro.

Në pikën II (dy) të dispozitivit ka detyruar të paditurën Kompania e Sigurimeve “S...” në Prishtinë, që këto shuma t’i paguaj në bazë të përgjegjësisë së ndarë atë 70 % me kamatë, si për mjetet e deponuara në bankë mbi një vit pa destinim të caktuar dhe atë nga data e marrjes së këtij aktgjykimi 15.12.2017 e deri në pagesën definitive, nën kërcënim të përmbarimit.

Në pikën III (tre) të dispozitivit ka refuzuar si të pabazuar kërkesëpadinë e paditësit përtej shumës së gjykuar, për kompensimin e dëmit jo material dhe atë në emër të dhimbjeve fizike, shumën prej 1,000.00 Euro, në emër të frikës së përjetuar shumën prej 1,500.00 Euro, në emër të zvogëlimit të aktivitetit jetësor shumën prej 600,00 Euro.

Në pikën IV (katër) të dispozitivit ka detyruar të paditurat Kompania e Sigurimeve “S...” në Prishtinë dhe Byroja Kosovare e Sigurimeve në Prishtinë, që paditësit A.A. në emër të kompensimit të dëmit jomaterial dhe material të shkaktuar si pasojë e lëndimeve të pësuar në aksidentin e komunikacionit të datës 24.10.2008, nga baza e autopërgjegjësisë t’ia paguajnë paditësit, shumat si në vijim:

Në emër të dëmit jomaterial:

për dhimbje fizike shumën prej 1,500.00 Euro

për shkak të frikës së përjetuar shumën prej 800.00 Euro

Në emër të dëmit material:

në emër të përkujdesjes së personit tjetër shumën prej 50.00 Euro,

në emër të ushqimit të përforcuar shumën prej 50.00 Euro.

Në pikën V (pesë) të dispozitivit ka detyruar të paditurat, që këto shuma t’i paguajnë në bazë të përgjegjësisë së ndarë dhe atë 70 % nga shuma e gjykuar të paguaj e paditura e parë Kompania e Sigurimeve “S...” në Prishtinë, shumën prej 1,680.00 Euro dhe shumën prej 30 % të shumës së gjykuar të paguajë e paditura e dytë Byroja Kosovare e Sigurimeve në Prishtinë dhe atë shumën prej 720.00 Euro, me kamatë si për mjetet e deponuara në bankë mbi një vit pa destinim të caktuar dhe atë nga data e marrjes së aktgjykimit 15.12.2017 e deri në pagesën definitive, nën kërcënim të përmbarimit.

Në pikën VI (gjashtë) të dispozitivit ka refuzuar si të pabazuar kërkesëpadinë e paditësit përtej shumës së gjykuar për kompensimin e dëmit jomaterial dhe atë në emër të dhimbjeve fizike shumën prej 500.00 Euro, në emër të frikës së përjetuar shumën prej 600.00 Euro

Në pikën VII (shtatë) të dispozitiviti ka detyruar të paditurat që paditësve t'ia paguajnë shpenzimet e procedurës kontestimore në lartësi prej 1,248.00 Euro dhe atë 70 % të paguajë e paditura e parë Kompania e Sigurimeve "S..." në Prishtinë shumën prej 873.60 Euro dhe 30 % të paguaj e paditura e dytë Byroja Kosovare e Sigurimeve me seli në Prishtinë, shumën prej 374.40 Euro në afat prej 15 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, e nën kërcënim të përmbarimit.

Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor ankesë kanë paraqitur:

I autorizuari i të paditurës së parë Kompania e Sigurimeve "S..." në Prishtinë, duke e goditur aktgjykimin për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore dhe vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, me propozim që Gjykata e Apelit e Kosovës aktgjykimin e atakuar ta prish dhe çështjen t'ia kthej gjykatës së shkallës së parë në rigjykim dhe rivendosje.

I autorizuari i të paditurës së dytë Byroja Kosovare e Sigurimeve me seli në Prishtinë, duke e goditur për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtë materiale me propozim që Gjykata e Apelit e Kosovës ta aprovoj ankesën, aktgjykimin e atakuar ta ndryshoj ashtu që ta refuzoj në tërësi kërkesëpadinë e paditësve apo aktgjykimin e atakuar ta prish dhe lëndën t'ia kthej gjykatës së shkallës së parë në rigjykim dhe rivendosje.

Përgjigje në ankesat e të autorizuarve të të paditurave, ka paraqitur i autorizuari i paditësve, me propozim që Gjykata e Apelit e Kosovës t'i refuzoj ankesat e autorizuarve të të paditurave, ndërsa aktgjykimin e atakuar ta vërtetoj.

Gjykata e Apelit e Kosovës si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar dhe komplet shkresave të lëndës, në mbështetje të dispozitës së nenit 194 dhe 195 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

Ankesat e të autorizuarve të të paditurave janë të pabazuara.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësit U.H. dhe A.A. që të dy nga Fushë Kosova, në gjykatën e shkallës së parë përmes të autorizuarit të tyre kanë ushtruar padi kundër të paditurave Kompania e Sigurimeve "S..." në Prishtinë dhe Byroja Kosovare e Sigurimeve në Prishtinë, për kompensimin e dëmit material dhe jomaterial të shkaktuar në aksidentin e datës 24.10.2008, me arsyet sikurse në padi.

Gjykata duke vepruar sipas padisë dhe kërkesëpadisë së paditësve, pas shqyrtimit dhe administrimit të provave të paraqitura nga palët ndërgjyqëse si dhe vlerësimit të të gjitha shkresave

tjera të lëndës, ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar me numër C.nr.2307/2012 të datës 15.12.2017, me të cilin e ka aprovuar pjesërisht si të bazuar kërkesëpadinë e paditësve duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar.

Në arsyetim të aktgjykimit të atakuar gjykata ka theksuar se për të paditurën e parë nuk ishte kontestuese baza e kërkesëpadisë por vetëm lartësia, gjersa ka pranuar përgjegjësinë e ndarë dhe atë 70 % për të paditurën e parë dhe 30 % për të paditurën e dytë. Kontestuese ishte baza e kërkesëpadinë për të paditurën e dytë, duke konsideruar se në bazë të aktgjykimit penal, përgjegjëse për kompensimin e dëmit është e paditura e parë, duke konsideruar se nga ai aktgjykim fajtor i vetëm ishte shpallur i siguruari tek e paditura e parë. Gjithashtu e paditura e dytë ka kontestuar kërkesëpadinë e paditësve, duke theksuar se kërkesat e paditësve janë parashkruar konform nenit 357 të LMD-së.

Tutje gjykata ka arsyetuar se nga provat e administruara ka rezultuar se paditësit kanë pësuar lëndime trupore si pasojë e aksidentit të datës 24.10.2008, i cili aksident sipas ekspertizës së komunikacionit të datës 26.01.2017 të ekspertit S.B. rezulton se M.L. (drejtues i automjetit të siguarur te e paditura e parë) ka kontribut primar në shkaktimin e aksidentit, ndërsa U.H. (përndryshe paditësi i parë i cili drejtonte utomjetin me targa të huaja), ka kontributin sekondar në shkaktimin e aksidentit, ka dhënë kontribut në rritjen e vëllimit të dëmit. Kurse sipas ekspertizës mjekësore të punuar nga ekspertet M.H. – ortoped – traumatolog dhe Dr. S.B. – psikiatër, si dhe duke bazuar në dokumentacionin mjekësore dhe ekzaminimin e drejtpërdrejtë të paditësve, rezulton se si pasojë e këtij aksidenti paditësi U.H. ka pësuar lëndime trupore me thyerje (çarje) të kokës së rrezorit në pjesën e sipërme që merr pjesë në formimin e nyjës së bërrylit, dyshim për thyerje të kockës skafoide në nyjën e byzylykut të dorës së djathë, ndrydhje në qafë, gjoks, shpinë të shkaktuara nga rënia, goditja në sipërfaqe të fortë, si pasojë e aksidentit në trafik dhe si të tilla këto lëndime bëjnë pjesë në lëndime të renda trupore. Me anë të ekspertizës është vërtetuar se si pasojë e lëndimeve paditësi U.H. pa përjetuar dhimbje fizike të intensitetit të rëndë 2 ditë, dhimbje që manifestohen për shkak të thyerjes së kockës të dorës së djathë, dhimbje fizike të intensitetit të mesëm që kanë zgjatur 25 ditë, periudhë kohore gjerë në marrjen e terapisë adekuate kundër dhimbjes e cila ndërlihet me kohen e nevojshme për konsolidimin e thyerjes, procedurat e ndërrimit të kohëpaskohshme të imobilizimit. Dhimbje të intensitet të ultë të cilat vazhdojnë edhe sot kohë e kësaj dite gjatë ndërrimit të motit dhe gjatë ngarkesës fizike, shëmtim trupor nuk ka. Paditësit U.H. i është nevojitur ndihma e personit të tretë 30 ditë që nënkupton ndihmën mjekësore profesionale dhe jo profesionale nga anëtarët e familjes e cila i ka mundur kryerjen e aktiviteteve ditore të ndryshme, si pasojë e paaftësisë së plotë dhe të pjesshme të shkaktuara nga thyerja e kockës së krahut të djathë dhe mbajtjes së imobilizimit me gips, ka pasur nevojë për ushqim të sforcuar me vitamina, karbohidrate të nevojshme për ngritjen dhe sanimin e kockës dhe reaksionit, shërim klimatik fizioterapeutik – psikik ka pasur nevojë për 15 ditë, i nevojshëm për përmirësimin e lëvizjeve në nyjën e bërrylit të djathë si dhe rritjen e forcës dhe masës muskulore të hipotrofuara (dobësuar), frikë primare në momentin e aksidentit, e përjetuar në formë të frikës

nga vdekja dhe kërcënimit direkt për integritetin e tij fizik, frikë sekondare të intensitetit të lartë me simptome të ankthit të gjeneralizuar, frikë nga invaliditeti, çrregullim gjumi, rikujtime të shpeshta të ngjarjes, çrregullim disponimi dhe ankesa të shumta somatike që kanë zgjatur për 24 orë. Frikë sekondare me intensitet mesatar më të ulët që kanë zgjatur 3 deri 4 muaj e manifestuar me reagime emocionale të karakterit anksioz, zgjime të herëpashershme gjatë gjumit dhe rikujtime të ngjarjes traumatike. Zvogëlim i përgjithshëm i aktivitetit jetësor në shkallë prej 5 %. Ndërsa për paditësin A.A. gjykata ka arsyetuar se i njëjti, si pasojë e aksidentit të komunikacionit të ndodhur me datë 24.10.2008, ka pësuar lëndime trupore, e sipas ekspertizës mjekësore të punuar nga ekspertet M.H. – ortoped – traumatolog dhe Dr. S.B. – psikiatër, është diagnostifikuar me përdredhje dhe zgjatje të muskulaturës së qafës dhe shpinës, ndrydhje të krahut të majtë, përdredhje të nyjës së zogut të këmbës së majtë të shkaktuar nga rënia, goditja në sipërfaqe të forta si pasojë e aksidentit në trafik dhe si të tilla lëndime bëjnë pjesë në lëndime të lehta trupore. Dhimbje fizike të përjetuara të intensitetit posaçërisht të rëndë nuk ka. Dhimbjet fizike të intensitetit të rëndë kanë zgjatur për 1 ditë, dhimbje që manifestohen për shkak të zgjatjes dhe përdredhjes së indeve të qafës të cilat japin dhimbje në çdo lëvizje. Dhimbje fizike të intensitetit të mesëm, që kanë zgjatur për 16 ditë, periudhë kohore gjerë në marrjen e terapisë adekuate kundër dhimbjes, e cila ndërlihet me kohën e nevojshme për konsolidimin e indeve të buta të pjesëve të lënduara. Dhimbje të intensitetit të ulët të cilat vazhdojnë edhe sot e kësaj dite gjatë ndërrimit të motit dhe gjatë ngarkesës fizike. Shëmtim trupor nuk ka. Paditësit A.A. i është nevojitur ndihma e personit të tretë për 16 ditë që nënkupton ndihmën mjekësore profesionale dhe jo profesionale nga anëtarët e familjes e cila i ka mundësuar plotësimin e nevojave biologjike dhe fiziologjike, aktiviteteve ditore të ndryshme, si pasojë e paaftësisë së pjesëshme të shkaktuar nga lëndimet e pësuar, ka pasur nevojë për ushqim të përforcuar, me vitamina, karbohidrate, proteina, minerale të nevojshme për sanimin e lëndimit dhe reaksionit post traumatik. Shërim klimatik fizioterapeutik – psikik ka pasur nevojë për 10 ditë, i nevojshëm për përmisimin e lëvizjeve të qafës si dhe rritjen e forcës dhe masës muskulore të dobësuar si pasojë e kontrakturës së zhvilluar në qafës si pasojë e mos lëvizjes në kohën e shërimit. Frikë primare në momentin e aksidentit, e përjetuar në formë të frikës nga vdekja dhe kërcënimit direkt nga integriteti i tij fizik i cili ka zgjatur për disa sekonda. Frikë sekondare të intensitetit të lartë që ka zgjatur për 48 orë e shoqëruar me ankth, shqetësim dhe simptoma përcjellëse të reagimit akut ndaj stresit. Frikë sekondare me intensitet të mesëm dhe të ulur që ka zgjatur për 2 deri 3 muaj e përcjellur me padisponim, probleme me gjumë, rikujtim të ngjarjes traumatike si dhe ankesa të shumta somatike. Frikë dhe pasiguri ka edhe sot e kësaj dite në pjesëmarrje në komunikacion por të intensitetit të ulur. Zvogëlim të aktivitetit jetësor nuk ka.

Gjykata me aplikim e dispozitës së nenit 200 të LMD-së ka detyruar të paditurat që paditësve t'ua paguajnë në emër të shpërblimit të dëmit jo material dhe material shumë e përcaktuara si në pikën I, II, IV dhe V të dispozitivit në përpjesëtim 70 % për të paditurën e parë duke vlerësuar 30 % përgjegjësinë e të paditurës së dytë, në aksidentin e shkaktuar. Gjykata ka arsyetuar se duke i

vlerësuar të gjitha kriteret dhe masat për caktimin e lartësisë së shpërblimit të dëmit jo material e posaçërisht duke marrë parasysh natyrën e shkallës së dëmtimeve trupore të shkaktuara paditësve, në bazë të vlerësimit të ekspertizës mjekësore, gjykata duke iu referuar edhe ndarjes së përgjegjësisë miratoi pjesërisht kërkesëpadinë e paditësve në vlerat e shpërblimit të dëmit si në pikën I, II, IV dhe V të dispozitivit të aktgjykimit, duke i vlerësuar si shpërblime reale, objektive dhe me bindjen se ky shpërblim është në pajtueshmëri me natyrën dhe pasojat e lëndimit.

Për pjesën e refuzuar të kërkesëpadisë, gjykata e shkallës së parë ka arsyetuar se kompensimi i kërkuar në emër të dëmit jo material mbi shumat e gjykuara përtej pjesës aprovuese nuk do të ishte në harmoni me të mirën e shkelur dhe me qëllimin që kompensimi të ishte i drejtë.

Vendimin për kumatën gjykata e ka mbështetur në dispozitën ligjore të nenit 277 të LMD-së, ndërsa për shpenzime të procedurës gjykata është bazuar në nenin 449, 452.1 dhe 463 të LPK-së.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson se aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika (b), (g), (j), (k) dhe (m) të LPK-së, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të autorizuarve të të paditurave se aktgjykimi i ankimuar është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika n) të LPK-së. Aktgjykimi nuk është i përfshirë në të meta për shkak të cilave nuk mund të ekzaminohet dhe në lidhshmëri me këtë dispozitivin e aktgjykimit është i qartë dhe i përmbarueshëm dhe përmban arsye për të gjitha faktet vendimtare të cilat janë marrë në vlerësim nga gjykata e shkallës së parë e sipas të cilave edhe është vendosur lidhur me themelësinë e kërkesëpadisë. Në këtë kontekst në arsyetim të aktgjykimit janë dhënë arsye të duhura për mënyrën e vërtetimit të fakteve, për provat e administruara dhe për vlerësimin e tyre sa i përket besueshmërisë dhe fuqisë provuese të tyre. Gjykata në arsyetim të aktgjykimit për pjesën e aprovuar të kërkesëpadisë ka paraqitur arsye në lidhje me secilën kërkesë të paditësve për dëmin jomaterial dhe material si dhe ka dhënë arsye të mjaftueshme për refuzimin e kërkesëpadisë së paditësve përtej shumave të aprovuara si në dispozitivin e aktgjykimit të atakuar.

Të pabazuara qëndrojnë pretendimet ankimore të autorizuarve të paditurave për gjendjen faktike, pasi që nga shkresat e lëndës konstatohet se të gjitha faktet e çështjes lidhur me çështjen kontestuese në fjalë nga gjykata e shkallës së parë janë provuar me prova përkatëse të cilat janë administruar në procedurën kontestimore të udhëhequr tek ajo gjykatë, e cila gjendje faktike e

vërtetuar dhe konstatuar nga gjykata e shkallës së parë është e pranueshme edhe për Gjykatën e Apelit, pasi që kjo gjykatë vlerëson se ka mbështetje të plotë në provat shkresore.

Gjykata e Apelit vlerëson se në kuptim të dispozitave materialo-juridike të cilave iu është referuar gjykata e shkallës së parë e në përputhje me gjendjen faktike të konstatuar, duke marrë në konsideratë natyrën e lëndimeve trupore të cilat i kanë pësuar paditësit në aksidentin e ndodhur, e duke marrë për bazë edhe rrethanat tjera që ndikojnë në përcaktimin e lartësisë së kompensimit, siç janë kohëzgjatja dhe intensiteti i dhimbjeve fizike, intensiteti dhe kohëzgjatja e frikës se pësuar, rezulton se shumica e gjykuar paditësve në emër të dëmit jo material të pësuar si shkak i aksidentit të ndodhur e duke u bazuar në ekspertizat e nxjerra nga ekspertët e lëmisë përkatëse, është në përputhje të plotë me qëllimin e kompensimit. Për këto kategori të dëmit jo material gjykata e shkallës së parë rezulton të ketë vendosur në mënyrë të ekuilibruar në mes të shumës së gjykuar dhe natyrës së lëndimeve, përkatësisht dëmit që kanë pësuar paditësit, duke siguruar që kompensimi i gjykuar të jetë satisfaksion për paditësit duke shmangur qëllimet tjera materiale që mund të bien ndesh me qëllimin e satisfaksionit në raste të tilla, me çka gjykata e shkallës së dytë aktgjykimin e ankimuar lidhur me këtë pjesë të kërkesëpadsisë e ka vërtetuar duke vendosur si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

Sipas vlerësimit të Gjykatës se Apelit, gjykata e shkallës së parë drejtë ka vendosur edhe sa i përket dëmit material të gjykuar paditësve në emër të ushqimit të përforcuar dhe në emër të përkujdesjes së personit tjetër, pasi që në bazë të mendimit profesional të dhënë nga ekspertët mjekësor është konstatuar se paditësi i parë U.H. ka pasur nevojë për ushqim të përforcuar dhe ndihmë nga personi tjetër në kohëzgjatje prej 30 ditë, ndërsa paditësi i dytë A.A. po ashtu ka pasur nevojë për ushqim të përforcuar në kohëzgjatje prej 30 ditë, ndërsa ndihma nga personi tjetër ka qenë e nevojshme për 16 ditë. Nën rrethanën e tillë kjo ka rezultuar me humbje materiale për paditësit, me çka kur merret parasysh natyra e lëndimeve të cilat i kanë pësuar, cili lloji i ushqimit shtesë përveç ushqimit të zakonshëm çdo ditë iu është nevojitur, koston e çmimeve ushqimore në Kosovë dhe praktikën e gjertanishme të Gjykatave të Kosovës rreth kompensimit për këtë lloj dëmi, kësaj gjykata i ka rezultuar se shumica e gjykuar nga gjykata e shkallës për këto kategori të dëmit material, ka mbështetje në ligj, por edhe me praktikën e gjertanishme gjyqësore.

Gjykata e shkallës së parë drejtë ka vendosur edhe lidhur me kamatën e gjykuar, pasi që kamata del të jetë marrë në përputhje të plotë me dispozitën e ligjit material të nenit 277 par.1 të LMD-së, i aplikueshëm ë kohën e shkaktimit të dëmit.

I drejtë ka rezultuar të jetë edhe vendimi mbi shpenzimet e procedurës i cili është në përputhje me dispozitat e LPK-së dhe sa i përket lartësisë është në harmoni me tarifën e Odës së Avokatëve dhe tarifatat për shpenzime gjyqësore.

Gjykata e Apelit, ka pasur parasysh pretendimin ankimor të të paditurës Byroja Kosovare e Sigurimeve lidhur me parashkrimin e kërkesëpadsisë në raport me paditësin e dytë A.A. nga Fushë

Kosova. Mirëpo këtë pretendim kjo gjykatë e vlerësoi si të pambështetur për faktin se nga shkresat e lëndës ka rezultuar që në rastin konkret ndaj M.L. (shkaktarit kryesor të aksidentit), është zhvilluar procedurë penale për rrezikim të trafikut publik nga neni 297 të Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës, e cila procedurë ka përfunduar me aktgjykim të formës së prerë, - me shpalljen e të pandehurit si fajtor për veprën penale në fjalë. Në prezencë të kësaj gjendje faktike dhe me referim në përmbajtjen e dispozitës ligjore nga neni 377 të Ligjit për marrëdhëniet e detyrimeve (1976), e cila përcakton se: *kur dëmi është shkaktuar nga vepra penale dhe për ndjekjen penale është parashkruar një afat më i gjatë parashkrimi, kërkesa për shpërblimin e dëmit ndaj personit përgjegjës parashkruhet kur të skadojë koha e caktuar për parashkrimin e ndjekjes penale*, rezulton se kërkesa për shpërblim dëmi e paditësit të dytë në raport me të paditurën BKS, nuk është kërkesë e parashkruar.

Nga arsyet e cekura, Gjykata e Apelit në mbështetje të dispozitave nga neni 194, 195 paragrafi 1, pika (d), e lidhur me nenin 200 të LPK-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË

Ac.nr.1832/18, me datë 15.07.2021.

Kryetarja e Kolegjit – Gjyqtarja,
Hunaida Pasuli